



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 218, datë 18.06.2020**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94 e 95 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Nenet 78/1-22 e 25 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi dhe Rexhep Karaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje”, të parashikuar nga neni 88/2 të Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Elisabeta Gjoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; i pandehur: {...}; Akuza: “Neni 135 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Enkeleida Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; i pandehur: {...}; Akuza: “Neni 321/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Engjëllushe Tahiri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; të pandehur: {...}dhe {...}; Akuza: “Neni 143/2 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Besnik Hoxhaj dhe Albert Meça, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria Kurbin; i pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 101/1 dhe 121/a/2 të Kodit Penal”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ardiana Bera (relatore), Gerd Hoxha dhe Vjollca Spahiu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Nenet 79/dh e 278/1 të Kodit Penal”.

#### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 291 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi jashtëkontraktor”.

#### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi (relator) e Olti Skrame, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

#### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Paulin Çera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Nenet 78/1, 300 të Kodit Penal”.

#### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Shkëlzen Liçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; i paditur: {...}; person i tretë: {...}, {...}; Objekti: “Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror”

#### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; e pandehur: {...}; Akuza: “Neni 170/a i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Marku (Çibuku), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen civile me palë paditëse: {...}; e paditur: {...}; Objekti: “Pavlefshmëri e aktit administrativ”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Pëllumb Vehbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; Objekti: “Gjykimin e procedimit penal nr.25, të vitit 2020, ndaj të pandehurit {...}, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i parë në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE**

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.91 prot., datë 24.02.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditës: {...}; të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitblerjes, etj.”

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Adelajda Gjuzi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Shpërdorim detyre”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 248 e 50/h i Kodit Penal”.

3. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.160 prot., datë 22.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, për caktimin e një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit {...} i akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/4 i Kodit Penal.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; i pandehur: {...}; Akuza: “Neni 242 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për pushim procedimi penal nr.43 viti 2019”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Merita Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë; të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Nenet 236, 262, 326/4 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Erjon Çela dhe Sami Ujkashi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Rishikimin e vendimit penal nr.241, datë 15.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në ngarkim të shtetasit {...}. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.241, datë 15.09.2017 deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor”.

### **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata (relatore), Selim Kryeziu dhe Vojsava Osmanaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Selim Kryeziu (relator), Valbona Vata dhe Vojsava Osmanaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kallëzues: {...}, {...}; Objekti: “Pushim i procedimit penal nr.1816, të vitit 2017 për veprën penale të “Kallëzimi i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës; Palë e interesuar: {...}; Objekti: “Miratimi i ekstradimit”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}; Objekti: “Dërgimi i çështjes për gjykim”.

## **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Hysen Saliko, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: {...}, “{...}”; person i tretë: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi (relator), Nazmi Troka dhe Hysen Saliko, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, {...}; të paditur: {...}, “{...}”; person i tretë: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Objekti: “Pushim procedimi.”
4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “Moskallëzim krimi”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Etleva Temo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Mimoza Margjeka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 298, të ligjit nr.7895, datë 27.01.1995, ndryshuar me ligjin nr.24/01/2001 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”.
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, Etleva Temo dhe Mimoza Margjeka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; i pandehur: {...}; Akuza: “Falsifikim i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal”.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Sokol Binaj dhe Albana Boksi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}’; kundër: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; palë të interesuara: Shoqëria tregtare “{...}”; {...}, {...}, etj.; Objekti: “Kthim i dosjes përmbartimore të sekuestruar”.
5. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Dhimitër Lara (relator), Sokol Binaj dhe Albana Boksi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë: të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Vrasja me dashje”; “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”; “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 76, 278/1 dhe 300 të Kodit Penal.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Mashtrim”, “Moskallëzim krimi”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Izet Salaj dhe Irena Brahimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Izet Salaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Përndjekja”.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri (relatore), Artur Gaxha dhe Alaudin Malaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Gaxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}; Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje”.
6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}, Shoqëria {...}; i paditur: Përmbarues gjyqësor {...}; person i tretë: {...}; Objekti: “Sigurim padie, etj.”

## **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}; Objekti: “Dërgimin e çështjes në gjykim”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 283/2 të Kodit Penal”.
3. Refuzimin e kërkesës nr.749, datë 04.06.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e një gjyqtari në çështjen penale në ngarkim të të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municioneve” dhe “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga nenet 79 e 22, 278/1 dhe 297 të Kodit Penal.
4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Flutura Skënderi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj.; i paditur: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi”.

## **GJYKATA E POSACME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bekteshi (relator), gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjyrokatër, Enton Dhimitri, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Esmeralda Xhili, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Nenet 109/b/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**